



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 12, datë 28.09.2023

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”(Ora 10²⁰)

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|----------------------|
| 1.Endri Hyseni | 23.Jerina Dervishaj |
| 2.Simo Petromilo | 24.Besmir Brahimi |
| 3.Myzafer Elezi | 25.Erëmal Arapi |
| 4.Rajmonda Zoto | 26.Lorel Canaj |
| 5.Vullnet Bilbilaj | 27.Illir Aliaj |
| 6.Edison Kapaj | 28.Elca Bezhani |
| 7.Simbol Pazaj | 29.Englantina Imeraj |
| 8.Anisa Ceno | 30.Marsela Dashi |
| 9.Vjola Xhafaj | 31.Atird Hoxha |
| 10.Gjergji Nika | 32.Klodian Xhyheri |
| 11.Frosina Qyrdeti | 33.Shkëlqim Leskaj |
| 12.Ardian Musta | 34.Geron Gunbardhi |
| 13.Liljana Breshani | 35.Bujar Osmanaj |
| 14.Sokol Kushta | 36.Aurora Qarri |
| 15.Evis Allushi | 37.Edlira Kapllanaj |
| 16.Arsen Belaj | 38.Arjan Isufi |
| 17.Novrus Rrokaj | 39.Elpiniqi Mërkuri |
| 18.Brikena Sika | 40.Briseida Çakërri |
| 19.Ervis Moçka | 41.Brikena Puka |
| 20.Ledja Shollaj | 42.Anxhela Shenaj |
| 21.Alta Haluci | 43.Grigor Dede |
| 22.Roland Strakosha | 44.Eglantina Aliaj |

Mungojnë :

- 1.Gëzim Çapoj
- 2.Eneida Vera
- 3.Dikens Bushaj
- 4.Liri Dëma
- 5.Refie Laze
- 6.Eda Begaj
- 7.Mujo Shakaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 12/1, datë 28.09.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Përsëndetje të gjithëve !

Vijojmë me shprehjen e ligjshmërisë ardhur nga prefekti i qarkut Vlorë.

Znj.Alta Haluci – Të mbajmë 1 minutë zi për Heroin e Kombit Afrim Bonjaku, (kosovar), pasi jemi një komb, një qëndrim.

(Mbahet 1 minutë heshtje në nderim të heroit).

Znj.Elpinqi Mërkuri – Lexon shprehjen e ligjshmërisë, shkresën e ardhur nga prefekti i qarkut Vlorë, ku VKB NR 63 ÷75, janë shpallur të gjithë të ligjshëm .

Faleminderit!

Vijojmë me rendin e ditës. Duke qenë se, në mbledhjen e konferencës së kryetarëve u shtuan dhe 2 projektvendime të tjera, ju kanë ardhur dhe me e-mail. Para se të kalojmë në rendin e ditës, kanë ardhur disa kërkesa në lidhje me pikën 4 të rendit të ditës. Mendoj ta shtyjmë për mbledhjen tjetër, ku secili prej jush të sjellë kërkesat, të shtojë zërat. Ta heqim këtë pikë.

Me këto ndryshime, votojmë rendin e ditës.

Z.Atird Hoxha – Të ngrihet kryetari i grupit, për kë bëhet fjalë.

Z.Ervis Moçka – E shtyjmë këtë pikë, për faktin që të paraqesin propozimet e tyre, të merren parasysh dhe kërkesa të këshilltarëve të tjerë. Për ca propozime zërash, kërkesa të këshilltarëve të tjerë.Për këtë arsye si grup menduam ta shtyjmë .

Z.Klodian Xhyheri – Kush është arsyeja , saktësisht .

Z.Erëmal Arapi – Nëqoftëse dhe herën do bëhen ndryshime, prapë do të shtyhet, prandaj na jepni ca arsye.

Z.Ervis Moçka – Është propozim, për arsyen që, nuk kanë paraqitur të gjithë kërkesat, për disa ndryshime të zërave, si trajnime, udhëtime studimore etj...propozojmë tu japim mundësinë , vendosëm ta shtyjmë.

Z.Atird Hoxha – Edhe ne kemi qenë pjesë e komisioneve,ka patur debate për ndryshime zërash. Ky është hartuar, është paraqitur. Në bazë të rregullores dhe, nga ne janë bërë propozime për disa ndryshime zërash.

Kush janë propozimet e miratuara ..

Kush janë miratuar..Nuk është ligjore, nuk është etike të hiqet kjo pikë.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Votojmë të hiqet pika 4 e rendit të ditës, të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Votohet.

Pro -35 vota

Kundër – 7 vota

Abstenim – 0 vota.

Miratohet, shtyhet pika 4 e rendit të ditës.

Z.Klodian Xhyheri – Siç e theksova dhe në mbledhjen e djeshme, të konferencës së kryetarëve të grupeve, për pyetjet e zotit Atird, është shumë kohë, nuk është kthyer përgjigje. Duhet të kishin ardhur dhe të ishin në rendin e ditës, 1 muaj kohë. Sot i erdhi përgjigje zotit Atird.

Z.Atird Hoxha – Siç është theksuar dhe në mbledhjen e kaluar dhe nga zoti Moçka, tek pika ” Të ndryshme “ duhet të jenë të pranishëm drejtorët e administratës . Janë problematika që duhet të gjejnë zgjidhje dhe për tu diskutuar në mbledhjen pasardhëse.Nuk është reflektuar asgjë. Nga drejtoresha e Sh.A.Ujësullës Kanalizime, erdhi një relacion, ku thuhet se, janë 45 pika që ujrart e zeza i derdhen në gjirin e Vlorës.Më vjen shumë keq,që të paktën për ato që kam konstatuar, erdhi materiali, por jo i plotë. Gjiri i Vlorës, është më i madh, por u konfirmuan nga relacioni që ka 45 subjekte që derdhen në gjirin e Vlorës.

Znj.Elona Hodaj – Është bërë para 1 muaji ky konstatim. Është ngritur 1 grup pune nga kryetari i bashkisë dhe AKUMI. Janë evidentuar 45 familje, jo biznese, janë vënë në dijeni , u është lënë që, brenda 10 ditëve të futen në rrjetin e kanalizimeve dhe me fondet e tyre, AKUMI, do të bëjë një rrjet të kanalizimeve.

Z.Ervis Moçka - Me të drejtë zoti Hoxha, në lidhje me shqetësimet e pikës, “të ndryshme”, nuk ndahen në të majtë dhe në të djathtë. Administrata të japë përgjigje. Zoti Hoxha për pikën që thoni, “ të ndryshme “, jam shumë dakort që të ketë pikë në rendin e ditës. U fut në procedurë, e ngriti si pretendim, nuk mund të japin përgjigje. Nuk mund ta diskutojmë që kjo përgjigje ti vijë vetëm zotit Hoxha, por për të gjithë këshilltarët. Jam shumë dakort që, për çfarë parashtrori , të jetë 1 pikë për të gjitha pyetjet e këshilltarëve.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në miratimin e rendit të ditës. Votohet.

Pro – 33 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 12/2, datë 28.09.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 1 të rendit të ditës, në “Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit të bashkisë, datë 31.08.2023”.

E kalojmë në votim. Votohet.

Pro – 35 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 12/3, datë 28.09.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 2 e rendit të ditës, miratimi i projektvendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë, për muajin gusht 2023”. Një raport nga administrata, drejtoria përkatëse.

Znj.Irena Stasa – Janë 31 familje përfituese të ndihmës ekonomike për muajin gusht, nga të ardhurat e bashkisë, kjo në bashki dhe njësi administrative. Është 1 familje e shtuar, e cila trajtohet me këtë skemë. Ka aplikuar, është kryefamiljare me kushte të këqija.

Z.Endri Hyseni – U mbledh komisioni juridik, u diskutua projektvendimi i ndihmës me të ardhurat e bashkisë. I vetmi shqetësim është vlera e ulët e ndihmës, që është ezauruar në çdo mbledhje... prandaj ju ftojme ta miratojmë.

Z.Klodian Xhyheri – I qëndroj përsëri kërkesës time. Me këto skema 3 mijë, 4 mijë, 6 mijë lekë, janë për të qarë hall. Nga qeveria bëhen këto. Bëhemi grup, i drejtohem parlamentit, këto lloj skemash janë qesharake. Kam dëgjuar dhe hasur nga qytetarë me probleme të ndryshme...nuk dijnë të aplikojnë, s’kanë mundësi. Të shohim dhe këtë pjesë. Nuk e kam për propagandë, kjo ndihmë duhet rritur. Kjo do pak kurajo.

Z.Ardian Musta – Nuk ndryshon vlera me këshill bashkiak.

Z.Ervis Moçka – Të bësh propagandë..., Është një VKM..., ta fillojnë ata. Këto janë diskutuar. Kemi shumë pika. Është thjesht një propagandë. Zbatohen kriteret për të marrë ndihmën. Ta lëmë propagandën. Kalojmë në miratim.

Znj.Elpinqi Mërkuri - Kalojmë në votim.

Pro – 40 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet. 3(tre) nuk marrin pjesë në votim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 12/4, datë 28.09.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 3 e rendit të ditës, miratimi i projektvendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar , për muajin gusht 2023”.

Znj.Irena Stasa - Nga fondi i qeverisë, përfitojnë 14 familje. 1 familje fitoi në sistemin dixhital. Është 6% nga fondi i qeverisë.

Z.Endri Hyseni – Edhe ky projektvendim u diskutua në komisionin juridik. Le ta kalojmë për miratim.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Votohet.

Pro – 42 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet. 1 (një) nuk morri pjesë në votim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 12/5, datë 28.09.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 4 e rendit të ditës, miratimi i projektvendimit “Për dhënien e miratimit për zhvillimin e pronës me nr. Pasurie 12/34 dhe 12/26 zona kadastrale 8602, e llojit truall me sipërfaqe 40.000 m² dhe 680 m² ndërtesë” me emërtimin sipas listës së inventarit stadiumi + aneksi i futbollit, të pronës me nr.pasurie. 12/37, zona kadastrale 8602, e llojit “truall dhe ndërtesë”, me sip. 9000m² dhe sipërfaqe ndërtese 3000 m²; të pronës me nr. Pasurie 12/49, zona kadastrale 8602, e llojit “ truall dhe ndërtesë”, me sip 455m² dhe të pronës me nr. Pasurie 12/325 , zona kadastrale 8602, e llojit “ truall dhe ndërtesë”, me sip 1881 m² të cilat ndodhen në pronësi të Bashkisë Vlorë në bazë të VKM-së 458/2018 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pronave të paluajtshme shtetërore, që përdoren për kryerjen e veprimtarive sportive“ dhe miratimin e Marrëveshjes “Për zhvillimin e projektit të zonës multifunksionale përreth kompleksit të stadiumit “Flamurtari” në Vlorë, përfshirë stadiumin, që do të nënshkruhet midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Bashkisë Vlorë, Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit si dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit”.

Për referim drejtorët përkatës.

Z.Dorjan Demiri/Drejtor Juridik – Bazuar në VKM Nr 17/2023 , qeveria shqiptare ka ngarkuar AKPT për realizimin e konkursit për rikonceptimin e stadioneve. Është bërë konkurs dhe projekti fitues, është Bashkia Vlorë. Numrat e pasurisë u thanë.

Qëllimi është ti japë zhvillim zonës social ekonomik. Bashkia Vlorë i ka dërguar shkresë FSHZH për financim për këtë projekt. Është shprehur dakortësia.

Janë 2 pika të zhvillimit të këtij projekti; 1-miratimi i zonës së zhvillimit dhe 2-miratimi i marrëveshjes. Nga ana teknike, do të flasë zoti Klaudio .

Z.Klaudio Mehmetaj/D.Urbanistikës – Prezantimi me këtë projekt ide ,që ka dalë fituese nga konkurimi që zhvilloi FSHZH me AKPT. Zona e Stadiumit “Flamurtari “, aneksi, Pallati i sportit dhe pishina . Në të djathtë kemi projektin që është fitues, përfshirë aneksin dhe një pjesë të hapsirës që mungon infrastruktura. Një prezantim në lidhje me përputhshmërinë me planin vendor të 2017 (shpjegon në hartë)

1- zonë për ndërhyrje, është ngjyrë portokalli.

2-me ngjyrë të kuqe , pronat e bashkisë.

3-me ngjyrë portokalli, pjesa, zonë e miratuar si projekt ide , sipërfaqe 6,7 ha . Janë bërë dëgjesa publike. Kategoria kryesore është argëtimi,aktivitete të ndryshme, qendër multifunksionale.

Pasuritë publike dhe private,.. janë ndërtesa informale këto pasuri, privatizime. Si projekt ide , zhvillimi i propozimit,konsiston në studion fituese, pra, në rindërtimin e stadiumit “Flamurtari “, rikonstrukcionin e pallatit të sportit, rikonstrukcionin e pishinës, hapsira social ekonomike .

Znj.Elpiniaqi Mërkuri - Kryetarët e komisioneve, më pas vijojmë me diskutime.

Z.Endri Hyseni – U diskutua në mbledhjen e komisionit juridik. Jemi përballë faktit që ti japim mundësi zhvillimit të kësaj zone. I vetmi kundërshtim nga opozita , ishte fakti për objektet që do ndërtohen brenda zonës. Qëllimi , është dhënia e miratimit për zhvillimin e zonës.

Z.Sokol Kushta – Falënderoj kolegët e mi që e kaluan dje në mbledhjen e komisionit. Kjo është multifunksionale. Ne që njohim Vlorën dhe sportin, kemi pas dëshirën e ndërtimit të një stadiumi. Në fushatë elektorale, pashë një angazhim nga ana e kryetarit dhe po e zbaton duke parë që sporti në Vlorë ka shumë deficiente. Sot ta kalojmë këtë projekt, që ti japim zhvillim asaj zone. Le ta kalojmë në votim ...

Z.Atird Hoxha - Të flasësh për sportin pas Sokol Kushtës,nuk është e lehtë.Do donim më të mirën për Flamurtarin, për ekipet zinxhir. Nuk jemi kundër zhvillimit të zonës. Ti themi gjërat ashtu siç janë . Kjo është një zonë e tërë që do kthehet në kantier ndërtimi për kulla. Nëqoftëse, do ti rikthehem projektit...aty aktualisht është një kullë, 1 leje ndërtimi. Mendoj, e para , kjo zonë mos të kthehet në zonë ndërtimi.., këto vijnë si paketë. Le të bëhet aneksi , etj...

Kam disa pyetje :

1-Në projekt, prishet ku është sot zjarrfikësja dhe bëhet kull. Pse prishet dhe bëhet kullë?

2-Aneksi..., a do të shpronësohen këta njerëz? Është një kullë... A keni marrë kontakt me këta njerëz...Ne jemi dakort të rikonstruktohet aneksi, stadiumi , por jo të ngrihen kullat .Ky projekt nuk mund të marrë miratimin tonë, ku janë 4 kulla. Pra, mos ta ngatërrojmë sportin me ndërtimin e kullave dhe zhvillimin e biznesit. Pra, të ishte e gjithë zona sportive dhe, jo kulla për interesa të tyre.

Z.Illir Aliaj – Ky projektvendim kaloi dhe në komisionin tonë si dhe komisionin e arsimit...Është në rang kombi, midis 3 qyteteve është zgjedhur dhe Bashkia Vlorë. Pra, për zhvillimin e zonës , që i vijnë miljona euro qytetit tonë. Kërkesat që u paraqiten në mbledhjen e komisionit, drejtoritë i sqaruan tani. Kullat, nuk dihet funksioni, flitet për hoteleri, akomodime nga ekipe të tjerë. Është qendër multifunksionale. U bë konkursi, ky është projekt fitues. Nuk do prishet kulla ekzistuese , por uniformë për përmirësimin e infrastrukturës, do të bëhen dhe të tjerat. Sa për shpronësimet , ju

Z.Gjergji Nika – S’ka vetëm terrene sportive. Mos të shpronësohen në vlerë monetare, por në zonë banimi. Paralelisht me këtë projektvendim të kishte ardhur dhe një projektvendim në lidhje me terrenet sportive.

Z.Ermal Dredha – Ka pasur takime me qytetarët. Hapi i dytë...Sot kërkohet financim. Hapi i parë, fitoi projektin Bashkia Vlorë. E kanë bërë Durrësi,.. si fillim financimi dhe do vazhdojnë konsultimet, kompensimi, shpronësimi..Patjetër që do ketë. Do jem në krahë të komunitetit. Pjesa e zhvillimit, është investim serioz, për strukturat sportive. E shoh si zhvillim në tërësi, gjithnjë në konsulencë me qytetarët. Do të shohim dhe për terrene sportive, mund të negociojmë dhe me FSHZH për këto.

Z.Sokol Kushta – Pjesa mbas aneksit, është hoteleri, do të jetë për ekipet kombëtare. Është në shërbim kjo për sportin. Ndërsa për zhvillimin e disa fushave, terreneve sportive...është një zhvillim ...E keni menduar dhe, kryetari i bashkisë e ka në fokus.

Z.Atird Hoxha – Sqarimi...do të jenë disa investime që nuk i përkasin sportit. Tek zjarrfikësja, do bëhet një kullë.

Pallati që është do ngelet dhe, do unifikohet me 3 kulla të tjera. Të marrim përgjigje.

Znj.Alta Haluci – Duhet të kuptojmë një gjë , që nuk do njeri të bëhet stadiumi, pishina ? Po flasim gjithmonë për paketën. Kalohe, pastaj bëhet dëgjesa. Me fondet e FSHZH do bëhen fushat, po kullat kush do ti bëjë ? Është e njëjta gjë si dëgjesat publike për ujësjellësin. Çfarë do të bëhet me këta njërez të këtyre familjeve ? Është bërë ky diskutim ? Për stadiumin jemi dakort, për pishinën , po dakort, por për kullat ..

Z.Klaudio Mehmetaj – Në vijim të pyetjeve, për projektin, qeveria bëri një thirrje, shpallje dhe konkursi u bë në teatrin “Petro Marko “, 3 projekte ...Pra, kemi një projekt ide. S’kemi një projekt përfundimtar zbatues , pra ku mund të jenë këto përdorime socialekonomike. Për pikën 2, cilat janë këto pasuri?

Z.Atird Hoxha – Pra, tek zjarrfikësja, është 1 kullë. Nuk e prek zjarrfikësen?

Z.Illir Aliaj – Është ekzistuesja .

Znj.Sonela Haxhiraj – Po flasim për një projekt ide. Nuk kemi Vendim të KKT-së. Është Faza I e zhvillimit. S’kemi një leje infrastrukture.

Z.Dorjan Demiri – Jemi në fazën fillestare, jemi në Në faqen 4 të marrëveshjes ...

Z.Shkëlqim Leskaj – Kemi projektin paraprak dhe, është hedhur projekt ide, kemi pronë publike dhe pronë private. Në momentin që miratohet zbatimi ... Ne jemi në një fazë që ti japim të drejtën që kryetari i bashkisë të lidhë një marrëveshje . Jemi për interes të qytetit. Është dhënë mundësia për qytetin tonë.

Z.Endri Hyseni – Jemi përballë faktit që Bashkia Vlorë, të ndërmarrë këtë marrëveshje .

Znj.Elpinqi Mërkuri – Është investim shumë i rëndësishëm për qytetin tonë.

Z.Arjan Isufi – Të zhvillohet stadiumi i Flamurtarit, të zhvillohet sporti në Vlorë. Gjithë këshilltarët e pozitës, thonë që, jemi në hapat paraprakë . Pra, do votohet, po apo jo , për të ndërmarrë këtë marrëveshje ...Na është propozuar një projekt ide . Ma shpjegoni ..Çfarë funksioni kanë në kompleksin sportiv 4 kullat ? Është pasuri publike. Ky projekt ide nuk është i shtrirë vetëm në pasuri publike.

Z.Klaudio Mehmetaj – Nuk mund të shpjegoj funksionin e këtyre kullave. Është kompleksi

sportiv “Flamurtari”. Është dhënë ide paraprake dhe është shpall fitues projekti. Nuk mund të diskutojmë tani anën funksionale të këtyre kullave. Nuk është projekt i miratuar,.. nesër kur të miratohet...

Z.Dorjan Demiri – Në faqen 4 të marrëveshjes shpjegohet. Jemi në Fazën I.Nuk është bërë studimi i fizibilitetit..

Z.Arjan Isufi – Neni 1, pika 3,pika 2 ...lexon..rekreacioni...shlodhjen ...kush ma shpjegon si realizohet ky qëllim me ndërtimin e atyre 4 kullave ?

Z.Ermal Dredha – Materialet që përdoren sot, kundër ndotjes së ambjentit . Do të ketë hapsira të gjelbërta.., do ketë më shumë gjelbërim.., nuk ka infrastrukturë si duhet. Pra, do parë pjesa vizionare, do ti ngelet qytetit ky zhvillim...Le të jetë kulla, stadiumi, jo të ngelet një shtëpi pa leje...etj.

Z.Arjan Isufi - Bëhet fjalë për sipërfaqe publike, veç kompleksit të stadiumit...Ka prona private..Nuk u individualizuan ...pse nuk ka një nen që këta qytetarë do të shpronësohen.....

Z.Ermal Dredha – Kemi një investim Lungomare 3-Loti 2. Do të dëmshpërblehen me çmim tregu, ka hapsira ligjore. Kjo fazë sot , është që po kërkohet financim dhe në bazë të saj , bëhet dhe zhvillimi sa do investohet.

Z.Arjan Isufi – Nuk janë individualizuar pasuritë . Ka dhe zona informale.

Z.Klodian Xhyheri – Së pari , dëgjesat më duken qesharake...Stadiumi me kulla, pishina ... forma, është forma më gllabëruese e pronës private. Patjetër që vota ime do të jetë kundër. Nuk jam kundër zhvillimit .

Znj.Rajmonda Zoto – Kam qenë sportiste prej dekadash . Jam pro këtij projektvendimi. Do të doja që të ndërtoheshin amjente për ato disiplina që mungojnë, për të rritur cilësinë sportive.

Z.Ervis Moçka - Më vjen mirë për dakortësinë , për zhvillimin e zonës dhe të sportit dhe, për gjithë shqetësimet që ngrihen, mund të merren parasysh. Si do të zhvillohet zona. Vendim i KKT-së të vitit 2017, në Planin rregullues të qytetit, mund të hyjë ta shikojë kushdo.

Është bërë konkursi, u përcaktua fituesi. Firma belge, s’ka bërë vetëm përcaktim, pra, në zhvillimin e vizionit të saj sikurse dhe me investimin në lungomare.

Faza I , të kthehet në plan konkret, pra faza I fillestare dhe , shumë mirë që ngrihen shqetësimët.

Plani i fizibilitetit....pra, do të ketë një plan fizibiliteti, do të vijë përsëri. Do vijë plani i investimit, sa kosto reale ka dhe për shpronësimet. Jemi në fazën ku shqetësimet , shumë mirë që thuhet, por jo të marrin përgjigje. Pra, jemi në fazën ku kryetari i bashkisë të lidhë marrëveshjen. Pra, jemi në fazën paraprake për të dhënë dakortësinë . Sot nuk mund të diskutojmë për këtë projekt ide.

Ne si grup jemi dakort ti japim mundësinë kryetarit të bashkisë të lidhë marrëveshjen.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim. Votohet.

Pro – 35 vota

Kundër – 7 vota

Abstenim – 0 vota. Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 12/6, datë 28.09.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Viojmë me pikën 6 të rendit të ditës, miratimi i projektvendimit “Mbi miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit, për periudhën janar – gusht 2023” .
Z.Hiqmet Haxhaj – Lexon bazën ligjore , ku është mbështetur për hartimin e këtij raporti monitorimi. Kryetari i bashkisë ka për detyrë të paraqesë para këshillit këtë analizë çdo 4 muaj .
Sot raporti i monitorimit është për periudhën janar – gusht 2023.

Realizimi i të ardhurave – 389 mijë e.....

Fakt, të realizuara – 313 miljon e

Të ardhurat nga tarifat ,në 83%:

Plan – 235 miljon e ...

Fakt – 195 miljon e ...

Në total të ardhura të realizuara nga drejtoria e të ardhurave vendore në 80%.

Realizimi i të ardhurave nga agjenti tatimor dhe drejtoritë :

Plan – 1 miliard ...

Fakt – 812 miljon 068 mijë

Realizuar në masën 56%.

Administrata ka patur fonde me Drejtorinë e Thesarit, nga të ardhurat -1milyard 006 mijë

Fakt 462 miljon 266mijë e..... Në masën 45%

Nga granti i pakushtëzuar:

Plani - 643 miljon

-395 miljon janë përdorur, pra në masën 57,7%.

Granti specifik (arsim, pyjet, zjarrfikësen etj..)

Plan - 462 miljonë e....

Fakt - 298 miljonë e

Nga buxheti i shtetit

Plan - 835 miljon e

Realizim – 52 miljon e.....

Mirëmbajtje dekori dhe shërbim varrezash :

Shpenzimi total – 2 miliard e

Realizimi – 1 miliard 156 milion, pra realizimi në 53%.

Investimet për shkak të prokurimeve, kanë mosrealizim të dukshëm – 178 milionë, pra rreth 25% realizimi i investimeve. Për periudhën janar – gusht këto janë pak a shumë shifrat, ky është raporti i monitorimit .

Znj.Elca Bezhani – Në komisionin e ekonomisë dhe financave , dëgjuam relatimin e zotërisë, për analizën 8 mujore. Është analizë e detajuar me shpenzimet dhe të ardhurat. Patëm disa diskutime, për hartimin e buxhetit të vitit 2024 dhe dhamë sygjerrime për administratën që gjatë periudhës së hartimit të buxhetit , të marrë konsultimet dhe opinionet dhe nga grupet e interesit.

Z.Atird Hoxha – Falënderoj zotin drejtor të financës , por realizimi i investimeve në 25% i ulët , e cila tregon punën e dobët të administratës. Kam konstatuar nga ky projektvendim se, rezultojnë të paderdhura – 130 milionë lekë të reja, nga SHAUjësllësi, të paderdhura në arkën e bashkisë.

1A ka bërë analizë kryetari i bashkisë , pse nuk janë arkëtuar këto lekë ?

2-Po SHAUK, pse nuk i ka derdhur këto lekë, a ka bërë ndonjë analizë. SHAUK është agjent tatimor. A ka një marrëveshje të firmosur midis Kryetarit të bashkisë dhe SHAUK?

3-A është zbatuar Neni 117

4-A janë konfirmuar përfaqësuesit e SHAUK Vlorë(nga bashkimi i operatorëve të ujësllësit)

5-Kush është konkluzioni i Kryetarit të bashkisë, në mardhënien me SHAUK, Vlorë?

Mos është kryetari aktual pjesë e abuzimit, përveç kryetarit që iku? SHAUK është agjent tatimor

Znj.Elca Bezhani – Ne e trajtuam në komision pjesën e borxhit në bazë të ligjit Nr 9920, Neni 117, për agjentin tatimor. Ne e diskutuam me administratën, drejtorin e financës dhe drejtorin e tatimit taksave të bashkisë që si do operohet për të marrë këtë borxh, këtë detyrim, mos ti përdorin për vehte. Lind pyetja, SHAUK kalon në varësi të ministrisë, ku bashkia ka 49%, ka të drejtë të kërkojë borxhin. Të hartohet një plan i mirëfilltë nga drejtoria e tatimit taksave për ta marrë nga agjenti tatimor.

Z.Hiqmet Haxhaj – Borxhi, bëhet fjalë për vitin 2022 dhe një pjesë të vitit 2023. SHAUK ka pasur probleme me përmbaruesit , për xhirimin e lekëve për bashkinë. Mendojmë që brenda vitit ta mbyllim këtë si çështje . Edhe ne jemi aksioner. E kemi kontratën me ata.

Z.Erëmal Arapi – Borxhi që është krijuar....Bashkia e ka audituar për këtë borxh SHAUjësllësin?

Administrata e ka konstatuar dhe e ka lënë evazive.

Znj.Elca Bezhani – Pra, këto lekë të përdorura për të tretë.

Z.Arjan Isufi – Puna e përmbaruesve..Zonja Elca , theksoi për paligjshmëri...Kanë detyrim ligjor, kush auditon etj.. bashkia nuk ka bërë ndonjë ankesë pranë gjykatës...Jo të themi që është e pamundur..Pra, është justifikim. Kjo shifër 130 milion lekë të reja, kjo do jetë shumëfishuar më vonë. Ato lekë mund të përdreshin për investime .

Z.Illir Aliaj – Në lidhje me këtë pikë, i bëj thirrje drjtorit të financës, që kjo pjesë të trajtohet dhe tek marrëveshja, në lidhje me SHAUjësllës, pjesë e AKUMI, ti ngarkohen borxhet, karshi aseteve të ujësllësit.

Z.Shkëlqim Leska – I drejtohem administratës së bashkisë. Bashkia me Ujësllësin , bëjnë një rakordim...Masat që janë marrë...Zgjidhja që ka bërë bashkia që, taksat e saj mos të pengohen nga përmbaruesi , por që ti përdorë për vehte.

Z.Ervis Moçka – Është pika më e rëndësishme . Është një relacion , ku çdo drejtori ka dhënë financat e veta. Vihet re jo vetëm borxhi i akumuluar..., nuk është kryer derdhja ...

Agjenti tatimor, nga familjet -26%. Është detyrim që të mblidhet. Agjenti për familjet në 26%, nuk e ka derdhur shumë. Administrata të ulet me agjentin tatimor. Kush është arsyeja për mosderdhjen ? Administrata të ulet me agjentin tatimor, e bën se bën dot ? Ne familjarët - 26%, janë shumë familje që nuk e paguajnë.Shum, shumë e vogël .Taksa mbi pasurinë e paluajtshmeËshtë një problem që të zgjidhet nga administrata.

Z.Erëmal Arapi – E kishte administrata këtë problem, para marrëveshjes. Administrata e ka konstatuar . Projektvendimin e kaluat me shpejtësi, tani thoni që të ulet administrata me agjentin tatimor. Kemi ministrinë 51% me 49%.

Z.Atird Hoxha – Kam 1 pyetje në lidhje me raportin e monitorimit..Sa është realizimi i gjithë performancës së Bashkisë Vlorë, në përqindje sot ?

Z.Hiqmet Haxhaj – Për ujësllësin, ujësllësi e ka të kontabilizuar, jo të negociojmë më për borxhin . Vetëm afati kohor.

Total i të ardhurave - 56% , shpenzimet 53,6%

Znj.Elpinqi Mërkuri – I mbyllim diskutimet. Kalojmë në votim.

Pro – 38 vota

Kundër – 6 vota

Abstenim – 1 votë

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 12/7, datë 28.09.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 7 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e planit të mbarështimit të pyjeve “.

Relaton zoti Nika.

Z.Illir Nika – Herën e kaluar , u shty kjo pikë, pasi këshilltarët kërkuan informacion më të plotë me hartat.

Janë të pranishëm Doc.Shkencave zoti Everest, përfaqësues i firmës fituese si dhe inxhinierin zotin Agim Muka.

Qeveria shqiptare , vitin 2024 e ka quajtur viti shqiptar i pyjeve, prandaj e kemi detyrim të kërkojmë nga ana juaj pëlqimin për të mbajtur funksionin mbrojtës. Plani i mbarështimit të pyjeve hartohet për një 10-vjeçar.

Lexon..... për hapjen e korridoreve, do bëhet pastrimi i pyllit ku dobëhet dhe gjenerimi i të ardhurave. Është i pranishëm dhe inxhinieri që do të sqarojë, por theksoj që është mestarisht 2 m që merr deti nga pylli. Do të flasë inxhinieri.

Do disiplinohet lëvizja e vizitorëve, do ketë tabela treguese, sinjale ku do jepet çdo informacion.

Pres pyetjet tuaja.

Z.Agim Muka/Inxhinier ,Sektori i pyjeve – Të krijoni një ide për planin e mbarështimit . Janë gjithësej 11.201 ha, kullotë dhe pyll. Kemi 7 ekonomi. Sipas vijës kufitare, kjo zonë është nga kallafeti deri tek “Sorkadhja”, kufiri ynë.

Parcelat janë 10, nga 58÷65, marrë me VKM, janë inventarizuar. Kufiri është deri tek “Sorkadhja “. Këtu përfshihet dhe fshati Trevllazër, ku ndahet me zonën e mbrojtur.

Është punar më qeverinë suedeze.

Është punuar gjatë 2, 3 vite me qeverinë suedeze, rreth 3 milion euro.

Nuk punohet në pyll, pa një plan menaxhimi. Ne punojmë me plan inventarizimi, menaxhimi të vitit 1985. I ka kaluar afati.

Nuk është rënduar bashkia, buxheti i saj, nga fondi ynë i sektorit të pyjeve.

Për shkak të mungesës së këtyre fondeve , kërkojmë të aplikojmë . Kemi filluar me ekonominë Kume-Shushicë, në Pyllin e Sodës.

Sipërfaqja e Pyllit të Sodës , është nga përfundimi i pallateve deri tek kanali i linjës elektrike, gjithësej 197 ha, nga ku 187 ha pyll dhe 10 ha tokë. Për vetë rëndësinë që ka ky pyll, por ky po shkatërrohet....sistemi rrënjor i tyre, erërat e fuqishme, deti po afrohet drejt tokës., rreth 3 km e prirur nga erozioni. Ndër masat më kryesore është pyllëzimi, i cili ul efektin “serë”....31mijë Pylli i Sodës., ku 24 mij ton carbon në vit dëm në shoqërinë njerëzore . Do pyllëzohet 32 ha, fillojmë me pikën 15, do vazhdojmë me parcela me radhë. Kemi fat që Pylli i Sodës, ka filiz të ri.

Janë 10÷12 ha për tu çliruar, rralluar. Më kryesorja është erozioni dhe, për këtë të ngrihet brez detar. Vende – vende, deti ka hyrë shumë në pyll. Dotë bëhet një brez, një gardh, në mënyrë që deti mos të hyjë në pyll. Problem janë dhe koridoret , shpesh bie zjarr. Kalojnë shumë vizitorë, kemi një plan, projekt për pastrimin e pyllit. Përveç Sodës, pyllin mbrojtës, kemi Ujin e Ftohtë. Kemi marrë masa si për hapje rrugësh etj. Këto janë disa nga problemet teknike (Shpjegon hartat).

-Foto që tregon erozionin.

-Vija e verdhë, ku ka qenë pyll.

-Vija e kuqe, ku është pylli sot.

-Gardhi i propozuar, mbulesë pyjore me gjatësi 1,4 km që do të ngrihet.

-Do të shfrytëzohen si korridore , ato ekzistuese

-Harta me numrin e parcelave.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Ka pyetje ?

Z.Geron Gunbardhi – Duke falënderuar inxhimierin, do pyesja. Fotot a janë reale, se atje nuk ka rrugë për të kaluar, apo i keni marrë ngaTë rruash Pyllin e Sodës dhe të bëhen ato që thatë , ne jemi dakort. Apo mos do ti bëni si fillim dhe pastaj do ti jepni me qira .A ka ndonjë vend bosh atje ?

Z.Agim Muka – Është një pronësi e dytë. Pyjorja ka pas 10 kontrata, 6 të zonave të mbrojtura, 4 tonat. Ligji lejon vetëm ndërtim druri...Të gjithë ata që shfrytëzojnë pyllin, janë pa leje.

Z.Ardian Musta – Përsa i përket kufijve të Pyllit të Sodës, ka 2 VKM,ku është hequr zona pyll. Dhe ka 1 VKM - zonë ekonomike. Si e keni zgjidhur ngërçin e zonës ekonomike.

Z.Agim Muka – VKM për zonën ekonomike, nuk na prek neve. Ai është shfuqizuar . Deri më sot këto parcela, 16 dhe 19 janë zënë nga ndërtimet. Me VKM Nr 683 , i kam në inventar.

Z.Ardian Musta – Ka rërë vetëm pjesa e zonës industriale.

Z.Agim Muka – Nuk na prek ajo zonë. Ai vend ka rërë. Unë bëj vetëm transferimin.

Z.Atird Hoxha – Edhe mbledhjen e kaluar kam bërë një kërkesë , në ambjentin e portit, për

tecet lundruese. Keni bërë akt konstatimi, kush e ka shkaktuar këtë dëm ? Ju vini me një projektvendim për ta shtuar, një tjetër bën këto.

Z.Agim Muka - 3÷4 ditë para mbledhjes së kaluar, kemi snë vend si zyrë, kemi bërë procesverbal konstatimi, pra të vlerës së dëmit. Proçedurat vazhdojnë. Depresion i madh ujon me bimësi , kallamishte. Ishte një pishë e rrëzuar...Është çentirë, depresion uji. Nuk e kemi ne këtë tagër.

Z.Atird Hoxha - E kam ngritur këtë problem dhe në mbledhjen e komisionit.

Z.Agron Muka – Është depresion ujon.

Z.Illir Nika – I kemi dërguar shkresë AKMT, fotot.

Z.Atird Hoxha – Dëmtimi...,Janë dëmtuar pisha...janë kallamishte? Unë ngrita një shqetësim.

Z.Agim Muka – Dëm në vlerë materiale, as rrethim nuk ka .

Z.Atird Hoxha – S’ka dëmtime.

Z.Klodian Xhyheri – Ky projektvendim, është një projektvendim që, të gjithë e duam, mbarështimin e pyjeve. Ky pyll është mushkria e qytetit. Të shtohet, të mbarështohet. Jam shumë dakort. Pra, vetëm të mbillet, të shtohet. Ne të gjithë duhet të vëmë një gur në atë që kanë bërë prindërit tanë. Jemi pro mbarështimit , rruajtjes së pyjeve, jo me kulla. Të bëhemi bashkë

Znj.Elpinqi Mërkuri – Do të ishte një nismë shumë e mirë, për mbjelljen e pemëve nga të gjithë.

Znj.Edlira Kapllanaj – Falënderoj zotin Agim për sqarimin. Sqarimi është shumë i saktë .

Jetojmë të gjithë në planetin tokë. Më vjen mirë që vjen ky projektvendim, për mbarështimin e pyjeve. Jap votën time pro për këtë projekt.

Z.Ervis Moçka – Më vjen mirë që këshilltarët të gjithë janë dakort. Një përgjigje në lidhje me shqetësimin e këshilltarëve, se çdo bëhet më pas. Nuk mund të ndryshojë dhe të bëhet asgjë , pa ndryshuar plani vendor. Kjo është e gjitha pyll. S’mund të ndërtohet asgjë përveç ndërtimeve me dru. Të vazhdojmë të kalojmë materialin me sigurinë pyll.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Ky projektvendim, do kalojë pa pikën 2, ishte lapsus.

Z.Daut Zëraj – Nëse, ju është dërguar, është hequr pika, për zhvillimin e turizmit.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim, pa pikën 2 , për zhvillimin e turizmit.

Votohet.

Pro – 37 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 12/8, datë 28.09.2023

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 8 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e aneks marrëveshjes së nënshkruar midis “Shprehje e dakortësisë së palëve për dhënien/marrjen në përdorim të ambjenteve ku do të vendoset Arkivi i Urbanistikës së Këshillit të Qarkut Vlorë”.

E kalojmë në votim. S’keni gjë ?

Votohet.

Pro – 37 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 12/9, datë 28.09.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 9 e rendit të ditës, miratimi i projektvendimit “Për emërtim rruge në territorin e Bashkisë Vlorë “ me emrin “ Sherif Sinaj “.

Një referim nga drejtoritë përkatëse.

Z.Dorjan Demiri – Është rruga pranë Gjykatës. Zotëria ka humbur jetën në këtë vend.

Znj.Alta Haluci - Nuk kam kundërshtim me emrin Sherif Sinaj. Jam për emërtimin e rrugëve të vjetra, si Vrenez, Karabash etj.. Lexova jetëshkrimin ...kundër rregjimit të urryer, të Ahmet Zogut., Por kjo shprehje “e urryer”...në këtë pikë, nuk ka askush të drejtë, nuk mund të shkruhet kur kjo është e ndaluar. S’kam gjë me emrin.

Z.Erëmal Arapi – S’ka lidhje të qenit antizogist etj..Besoj që ata që ia shkruajnë kryetarit..., ashtu si gjithë populli. Prandaj, është sensitive situata. Administrata, merrni njerëz që të shkruajnë mirë.

Z.Daut Zëraj – Këto raste kalojnë pa debate. Tek relacioni, të hiqen pozicionimet që do shoqërojnë vendimin e zbardhur.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Faleminderit. Evidenca është shumë e saktë.

Z.Atird Hoxha – Pra, të hiqet kjo termë...e urryer ..Jam dakort me zotin Arapi, kujdes kur firmosen, çfarë shkruhet.

-Në luftën e Vlorës, nuk pranonin nën moshën 20 vjeç....të hiqet. Këto mund të vijnë kështu, këto emërtime. Këto duhet të kalojnë nëpërmjet Komisionit të Vlerësimit të Titujve.

E para, nuk është ndjekur procedura. Komisioni përkatës, duhet të ngrihet nga ky këshill. Është në shkelje të procedurave. Të vijmë e të themi ..lexon...luftoi., nuk janë forma që përdoren nga administrata dhe me firmë të kryetarit.

Znj.Liljana Breshani – Unë do të doja të kishte emërtime të tjera, si rruga e trëndafilave etj...

Z.Illir Aliaj- Në këto projektvendime, mos të bashkëlidhni shkrimet e qytetarit. Në momentin që vjen, drejtoria juridike të bëjë projektvendimin.. Kanë të drejtë për këtë zotërinjtë.

Znj.Elpinijë Mërkuri – Kalojmë në votim. Votohet.

Pro – 30 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 12/10, datë 28.09.2023

Znj.Elpiniqi Mërkuri - Kalojmë në projektvendim e shtuar , në miratimin e projektvendimit “Për dhënien e miratimit për aplikim , nga ana e Bashkisë Vlorë pranë Shoqatës Europiane ACES EUROPE, për marrjen e statusit “Qyteti European i Sportit 2024”.
Si thoni, e kalojmë në Votim ?

Votohet.

Pro – 33 vota

Kundër 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 12/11, datë 28.09.2023

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Pika, “Të ndryshme”.

Znj.Brikena Puka – Ka qenë një nismë nga Bashkia Tiranë, për krijimin e Aleancës së Grave Këshilltare, në vitin 2015 . Ishte me sukses dhe për Vlorën, në vitin 2020. Qëllimi pse u krijua , është fuqizimi i vet grave këshilltare. Unë mendoj ta riorganizojmë takimin me gratë e këshillit bashkiak, që ti japim zë grave dhe vajzave , për zgjidhjen e problemeve dhe ndihmën që duhet t’iu japim, në Bashkinë Vlorë.

Drejtorja e shërbimeve në kategorinë e gratë e dhunuara, kryefamiljare etj..ka një procedurë shumë burokratike , me bonusin social, nga shumë, vetëm 1 e përfitoi.

Them të lehtësohen procedurat për pjesën e strehimit. Ta marrim si iniciativë , ne në këshillin bashkiak për ti përmirësuar këto.

Z.Klodian Xhyheri – Zonja Puka, faleminderit për problematikën që ngritët , problemin e grave . Kanë shumë frikë mësueset, pedagoget janë të shtypura. Forconi rolin e gruas, pa ngjyrë. Gratë nuk janë të lira politikisht. E forcojmë dot rolin e femrës?

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Grave dhe vajzave.

Z.Klodian Xhyheri – E forcojmë dot rolin e gruas, përtej të majtës e të djathtës, zonja Puka ?

Znj.Brikena Puka – Një nga qëllimet e aleancës, është vendimmarrja.

Znj.Evis Allushi – Do të ngre dy shqetësime , e para nga banorët , është kërkesë e tyre, në lidhje me shërbimin urban tek “ Kalaja “. Janë aktualish oraret 06.30; 07.30; ... nëse është e mundur nga administrata , të rregullohet ky lloj shërbimi, të shtohen oraret.

-Në Rajonin Nr 3 , rruga tek Kopshti Nr 10 , është e gërryer, pa asfaltuar . Nëse, kjo rrugë mund të asfaltohet.

Z.Atird Hoxha – Ti rikthehem mendimit të zotit Moçka , në lidhje me mungesën e drejtorëve dhe për kryetarin e bashkisë.

Shqetësimet që nuk kam marrë përgjigje:

-Problemi i ujit të pijshëm në 2 lagje në fshatin Trevllazër.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – I kemi deleguar.

Z.Atird Hoxha :

- Subjektet që derdhin ujrat në gjirin e Vlorës.

-Pra, 2 lagjet në fshatin Trevllazër

-Makinat e ngelura, parkuar në vite.

-22 punonjës e shtuar në NSHP, për shërbimin e varrezave, puna që po bëhet.

-Vijëzimet blu, përgjatë bulevardit.

-Akademia e Marinës, parkimi në këtë zonë..Kush i ka lidhur kontratat? Çfarë afatesh ka ?

-Kush i kryen këto punime, në godinën në qendër të Vlorës?

-Investimi në fasadat përgjatë rrugës Gjykatë e Vjetër – Shkolla e Muzikës...Në të dy anët e rrugës, nuk ka trotuarë.

-Rruga nga përfundimi i tynelit deri tek Ura e Izvorit/Orikum, është e gërryer pjesë pjesë . Ka probleme asfalti , burim aksidentesh. Të bëhet ose të thuhet pse nuk po bëhet ? Pra, mungon infrastruktura.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Keni shumë të drejtë për të gjitha problematikat . Por, që nuk mund të zgjidhen të gjitha ... Le të bëhemi bashkë , për problematikat e ndryshme dhe të shumta që ka. Ti japim kohë kryetarit të bëjë punën dhe ta ndihmojmë në punën e tij. Kam shpresën dhe besoj që puna do të bëhet. Në NSHP, me zotin Edmond Leka po punohet çdo ditë në mirëmbajtjen e varrezave dhe në shërbimin e pastrimit.

Z.Edmond Leka /DNSHP - Për sektorin e varrezave.., është për të gjithë shumë i ndjeshëm .

Punohet me 2 turne. Është një sipërfaqe 20-30 ha. Kjo punë nuk mund të bëhet shumë shpejt. Po punojmë, po marrim opinione pozitive. Shumë shpejt do të përfundojë. Pjesa e trotuarëve, bashkia po ndërmer disa projekte , do shohim në buxhetin e vitit 2024.

-Në lidhje me krahasitjen e pemëve, kanë qenë sëmundje e pemëve . ka qenë kërkesë e qytetarëve për ti prerë.

Z.Arsen Belaj – Bashkia Vlorë ka dhe 4 njësi administrative.

Në 8 vjet, të jetë bërë një gjë për Orikumin ! Nuk është vënë dorë. Kjo nuk është normale . Tek plehrat e Orikumit, gjendja është shumë alarmante.

-Mushkonjat, të spërkaten. Investime s’ka, por të mirëmbahen.

-Shkollat e Dukatit, Dukat fshat, Tragjas, Radhimë, nuk kanë nxënës, janë mbyllur.

Duhet gjetur një model. Po mbyllen shkollat. A ka ndonjë kusht, ndonjë koefiçient , të gjithë po vijnë në Vlorë. Merrni masa. Faleminderit.

Znj.Alta Haluci – “Bashkë Fitojmë “ jemi dakort për këtë bashkëpunim me gratë e Aleancës së grave këshilltare.

Znj.Elca Bezhani – Nga takimet më banorët në fshatin Panaja, proble është uji i pijshëm, ndriçimi në rruget hyrëse dhe rrugët e parcelave. Administrata të marrë masa.

Në Njësinë Administrative Qendër, kam kërkuar që këto probleme të zgjidhen.

-Bashkia Vlorë, për vitin 2024, të hartojë një axhendë të aktiviteteve kulturore . Është një indicie e “Aulona Folk”, e zotit Sejmen Gjokoli që zhvillon këtë aktivitet çdo vit.

-Ligji për administratorët e pallatit, ka dalë. Bashkia Vlorë, administrata ta shohë me përparësi.

Z.Klodian Xhyheri – Zjarrëvënia në vendgrumbullimin e mbetjeve. Çfarë problemi ka? Çfarë masash ka marrë bashkia , pse rindizen këto zjarre ?

Z.Illir Aliaj - Ka gaz metan.

Z.Klodian Xhyheri – Jepi zgjidhje...,nuk të amnistion.

-Shqetësim i banorëve të Rajonit Nr 5 , përballë ish-fabrikës së tullave. Rruga “A.Zylyftar “ ..etj A ka ndonjë planifikim urbanistika. Janë zona të pamexhuara .

-Është një problem midis rrugës “Dëshmorët “ dhe “Gjergj Kastrioti “, është mbyllur një rotondo. Le të merren masa . A marrim dot masa për mos tu shtypur tek vijat e bardha . Nga ana teknike ka probleme.

Z.Illir Aliaj – Shpreh shqetësimin e banorëve të Rajonit Nr 1. Nga ndërhyrja e projektit të Ujësjiellit, në lagjet :Partizani “ dhe “15 Tetori “. Është projekt i FSHZH. Është problemi i rrugëve, të kthehen në gjendjen e mëparshme. Kjo për mua kërkon vëmendje të veçantë. Po fillojnë shirat, le të mbyllen me çakëll.

Znj.Elpiniaq Mërkuri – Problem i ujit të pijshëm, shqetësim i banorëve tek “Bishti i Kalldrëmit”
Z.Myzafer Elezi - Banorët mbas pallatit të “Bios”-it, është një segment rrugor, rreth 80m për tu asfaltuar.

Z.Edison Kapaj – Është shumë problem ujësjiellit, uji i pijshëm në fshatrat Panaja- Kërkovë-Oshëtim. Gjendja është alarmante. Ka filluar një projekt...

-Aksi rrugor Bestrovë – Bunavi , është i pakalueshëm. Të paktën për këtë rrugë, nëqoftëse, bashkia s’mundet, të llojë me ministrinë e linjës.

-Babicë e Vogël , tek by-pass,banorët nuk futen dot në banesa. Mbase duhet ndonjë rotondo.

Znj.Rajmonda Zoto – Me cilësinë e Drejtores së Qendrës Shëndetësore Nr 3...I kemi bërë kërkesë bashkisë për lirim ambjenti...Bashkia është vënë në dijeni , për lirim e ambjentit nga një familjar, i cila pretendon që ka një dakortësi me Bashkinë Vlorë. Na nevojiten këto ambjente. Nuk kemi marrë asnjë përgjigje, kush është kompetent për lirim e këtij ambjenti. Kërkojmë ndihmën e bashkisë për lirim e ambjenteve.

Znj.Elpiniaq Mërkuri – Faleminderit. Mirë u takofshim në mbledhjen e radhës.